



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 51/2012**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Xhevdet Abazi kryesues, Vlastimir Dimić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterave publik para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore për zgjedhjet jashtëzakonshme lokale për kryetar komune në Ferizaj, në seancën e panelit të mbajtur me 24.04.2012, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** poshtë ankesa si e palejuar.

### Arsyetim

Me datë 22.04.2012, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK, dega në Ferizaj, me të cilën theksohet me datën 22.04.2012, në rrugën Ahmet Kaqiku në Ferizaj, subjekti politik LDK, ka vendosur fotot me numrin e kandidatit të saj për kryetar komune, duke e shkelur Rregullën Zgjedhore 13/2009 të fushatës zgjedhore si dhe Rregullën Zgjedhore 11/2009 Kodi i Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotot e vendosura të kandidatit për kryetar komune të LDK-së.

Neni 33 dhe 44 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), Rregulla Zgjedhore nr. 11/2009, Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2009 Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike, përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, siç del nga të gjitha dispozita ligjore dhe Rregullat Zgjedhore të lartcekura, ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësit e tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

PZAP-i nga shkresat e lëndës gjeti se:

**ankesa është e palejuar.**

Pasi që dispozitat e lartcekura ligjore të LZP-së dhe Rregullat Zgjedhore, i përcaktojnë të drejtat e subjekteve politike si dhe veprimet e ndaluara të tyre vetëm gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe meqenëse veprimet e pretenduara janë zhvilluar para datës së përcaktuar për fillimin e fushatës zgjedhore e të cilat nuk e parashohin sanksionimin apo marrjen e masave tjera ndëshkimore ligjore për vendosjen e posterave ne vende publike andaj në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 51/2012 më datën 24.04.2012.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Xhevdet Abazi**

